



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEĆA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-CA-2024-03

Vendosi: **Paneli i Dhomës së Gjykatës së Apelit**
Gjykatëse Mishelë Pikar
Gjykatës Kai Ambos
Gjykatëse Nina Jorgensen

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 24 korrik 2024

Gjuha origjinale: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Vendim mbi Modalitetet e Pjesëmarrjes së Viktimave në Procedurën e Apelit

Zyrës së Prokurores së Specializuar:
Kimbërli P. Uest

Mbrojtjes së Pjetër Shalës:
Zhan-Lui Zhilisen

Mbrojtjes së Viktimave:
Sajmon Loz

PANELI I DHOMËS SË GJYKATËS SË APELIT të Dhomave të Specializuara të Kosovës (përkatësisht “Paneli i Gjykatës së Apelit”, “Paneli i Apelit” ose “Paneli” dhe “Dhomat e Specializuara”),¹ bazuar në nenin 33(1)(c) të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) dhe rregullën 172 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave (“Rregullorja”), lëshon këtë Vendim.

I. HISTORIKU

1. Më 15 dhjetor 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake pranoi një viktimë si pjesëmarrëse në proces në çështjen KSC-BC-2020-04 dhe përcaktoi dispozitat e zbatueshme për pjesëmarrjen e viktimave në procedurën paraprake.² Më 11 gusht 2022, Gjykatësi i Procedurës Paraprake pranoi një viktimë tjetër në proces.³ Më 19 shtator 2022, Gjykatësi i Procedurës Paraprake pranoi gjashtë viktima të tjera në proces.⁴ Më 24 shkurt 2023, Trupi Gjykues përcaktoi të drejtat procedurale të viktimave pjesëmarrëse në gjykim.⁵ Më 16 korrik 2024, Trupi Gjykues lëshoi aktgjykimin e tij në këtë çështje, ku përmendi, ndër të tjera, se në proces morën pjesë tetë viktima.⁶

2. Më 19 korrik 2024, z. Pjetër Shala (“Shala”) kërkoi zgjatje të afatit për dorëzimin e njoftimit të tij për apel kundër Aktgjykimit.⁷

¹ F00002, Vendim për Caktimin e Panelit të Gjykatës së Apelit, 22 korrik 2024.

² KSC-BC-2020-04, F00123/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit të Parë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, 15 dhjetor 2021 (versioni konfidencial u dorëzua më 15 dhjetor 2021), para. 45-50.

³ KSC-BC-2020-04, F00249/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit të Dytë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, 11 gusht 2022 (versioni konfidencial u dorëzua më 11 gusht 2022), para. 42-43.

⁴ KSC-BC-2020-04, F00279/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit të Tretë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, 19 shtator 2022 (versioni konfidencial u dorëzua më 19 shtator 2022), para. 42-43.

⁵ KSC-BC-2020-04, F00433, Vendim mbi të Drejtat Procedurale të Viktimave gjatë Gjykitimit dhe Çështje lidhur me To, 24 shkurt 2023 (konfidencial, i riklasifikuar si publik më 6 mars 2023) (“Vendimi mbi të Drejtat Procedurale të Viktimave gjatë Gjykitimit”), para. 29-50, 62.

⁶ KSC-BC-2020-04, F00847, Aktgjykim dhe Dënim, 16 korrik 2024 (konfidencial) (“Aktgjykimi”), para. 13.

⁷ F00001, Kërkesë për Ndryshimin e afatit për Dorëzimin e Njoftimit për Apel të Mbrojtjes, 19 korrik 2024, para. 1, 15.

II. DISKUTIM

3. Paneli kujton se, pavarësisht nëse mbrojtësi i viktimave dorëzon apo jo apel sipas nenit 46(9) të Ligjit, pjesëmarrja e viktimave në procedurën e apelit para Dhomave të Specializuara është e lejueshme në qoftë se (i) është në pajtim me Ligjin dhe Rregulloren, (ii) kufizohet në çështje që prekin interesat e tyre personale, dhe (iii) nuk cenon ose nuk bie ndesh me të drejtat e të akuzuarve.⁸ Në vijim të jurisprudencës së mëhershme,⁹ Paneli i Apelit sqaron më poshtë se si zbatohen dispozitat ligjore të Dhomës së Specializuar në lidhje me pjesëmarrjen e viktimave në këtë procedurë apeli.

4. Në këtë kontekst, Paneli i Apelit vë në dukje analizën e Trupit Gjykses të interesave personale, të drejtave dhe modaliteteve të pjesëmarrjes së viktimave pjesëmarrëse në gjykim, bazuar në kornizën ligjore të Dhomave të Specializuara – konkretisht nenet 22(3), (5)-(6), 23 dhe 40(2) të Ligjit dhe rregullat 80, 114 dhe 132 të Rregullores, dhe thekson në veçanti se atyre u është lejuar të marrin pjesë në të gjitha seancat gjyqësore *jo-ex parte*, përfshirë konferencat përgatitore për gjykimin dhe konferencat përgatitore të Mbrojtjes.¹⁰ Rrjedhimisht, duke pasur parasysh faktin që rregullat e procesit të gjykimit zbatohen *mutatis mutandis* në procesin para Panelit të Apelit,¹¹ si dhe nevojën për koherencë procedurale në këtë çështje, Paneli konsideron se është në interes të drejtësisë që rregulla të ngjashme për pjesëmarrjen e viktimave, me përshtatjet e nevojshme, të zbatohen edhe gjatë procesit të apelit.¹²

⁸ Shih nenin 22(6) të Ligjit. Shih gjithashtu KSC-CA-2023-02, F00011, Vendim mbi Modalitetet e Pjesëmarrjes së Viktimave gjatë Procedurës së Apelit, 15 shkurt 2023 ("Vendimi mbi Pjesëmarrjen e Viktimave në Procedurën e Apelit në Çështjen *Mustafa*"), para. 5-6.

⁹ Shih Vendimin mbi Pjesëmarrjen e Viktimave në Procedurën e Apelit në Çështjen *Mustafa*.

¹⁰ Vendimi mbi të Drejtat Procedurale të Viktimave gjatë Gjykimit, para. 15-50. Shih gjithashtu KSC-BC-2020-04, transkripti, 18 tetor 2022, f. 302; KSC-BC-2020-04, Transkripti, 19 tetor 2022, f. 392; KSC-BC-2020-04, transkripti, 24 gusht 2023, f. 2343; KSC-BC-2020-04, Transkripti, 25 gusht 2023, f. 2427.

¹¹ Shih rregullën 173(3) të Rregullores.

¹² Shih rregullën 114(4) të Rregullores. Shih gjithashtu Vendimin mbi të Drejtat Procedurale të Viktimave gjatë Gjykimit, para. 31; Vendimi mbi Pjesëmarrjen e Viktimave në Procedurën e Apelit në Çështjen *Mustafa*, para. 7.

5. Paneli i Apelit konsideron se të drejtat e viktimave pjesëmarrëse në procesin e apelit janë domosdoshmërisht të kufizuara në pikat e ngritura para Panelit të Apelit dhe rrjedhimisht duhet të ushtrohen brenda kufijve të aspekteve që burojnë nga pikat e apelit.¹³

6. Paneli i Apelit rikujton se, sipas nenit 22(3) të Ligjit, interesi personal dhe të drejtat e viktimave pjesëmarrëse në proces janë njoftimi, pranimi dhe zhdëmtimi, dhe rikujton se, bazuar në nenin 23 të Ligjit, mbrojtja e sigurisë, mirëqenies fizike dhe psikologjike, dinjitetit dhe privatësisë së viktimave pjesëmarrëse është interes personal dhe e drejtë e katërt që viktimat pjesëmarrëse kanë në proces.¹⁴

7. Në lidhje me modalitetet e pjesëmarrjes së viktimave në këtë proces apeli, Paneli kujton fillimisht se ata mund të marrin pjesë vetëm përmes mbrojtësit të viktimave dhe, rrjedhimisht, nuk mund të përfaqësojnë vetveten.¹⁵ Gjithashtu, Paneli rikujton se ruan gjithmonë kontrollin mbi modalitetet e pjesëmarrjes së viktimave dhe se ato mund të ndryshohen dhe/ose plotësohen në disa raste për sa kohë që interesat personale të viktimave nuk ndikohen negativisht nga këto ndryshime ose plotësime.¹⁶ Gjithashtu, Paneli garanton që pjesëmarrja e viktimave në procesin e apelit as të mos cenojë dhe as të mos bjerë ndesh me të drejtat e të akuzuarit.¹⁷

¹³ Shih nenin 46(1) të Ligjit; rregullat 113(1)-(4), 175, 176(2), 182(2)-(3) të Rregullores. Shih gjithashtu Vendimin mbi Pjesëmarrjen e Viktimave në Procedurën e Apelit në Çështjen *Mustafa*, para. 8; Vendimin mbi të Drejtat Procedurale të Viktimave gjatë Gjykimit, para. 17.

¹⁴ Shih Vendimin mbi të Drejtat Procedurale të Viktimave gjatë Gjykimit, para. 18-20. Shih gjithashtu Vendimin mbi të Drejtat Procedurale të Viktimave gjatë Gjykimit, para. 21-28; Vendimi mbi Pjesëmarrjen e Viktimave në Procedurën e Apelit në Çështjen *Mustafa*, para. 9.

¹⁵ Nenet 22(5)-(6), 46(9) të Ligjit; rregulla 114(1) e Rregullores. Shih gjithashtu Vendimin mbi të Drejtat Procedurale të Viktimave gjatë Gjykimit, para. 29; Vendimi mbi Pjesëmarrjen e Viktimave në Procedurën e Apelit në Çështjen *Mustafa*, para. 10.

¹⁶ Shih Vendimin mbi të Drejtat Procedurale të Viktimave gjatë Gjykimit, para. 32. Shih gjithashtu Vendimin mbi Pjesëmarrjen e Viktimave në Procedurën e Apelit në Çështjen *Mustafa*, para. 10.

¹⁷ Neni 22(6) i Ligjit. Shih Vendimin mbi të Drejtat Procedurale të Viktimave gjatë Gjykimit, para. 32; Vendimin mbi Pjesëmarrjen e Viktimave në Procedurën e Apelit në Çështjen *Mustafa*, para. 10, poshtëshënimi 24 dhe referencat në të.

8. Konkretisht, mbrojtësi i viktimave vazhdon të ketë qasje në të gjithë dosjen e çështjes, përfshirë të gjitha parashtrimet e protokolluara, transkriptet, dhe materialet provuese publike, konfidenciale dhe rreptësisht konfidenciale, por duke përjashtuar materialet që janë *ex parte* mbrojtësit të viktimave.¹⁸ Në këto rrethana, mbrojtësi i viktimave duhet të njoftohet për të gjitha materialet e dosjes që nxirren dhe/ose shpërndahen, ku përfshihen të gjitha parashtrimet e protokolluara, dhe transkriptet, publike, konfidenciale dhe rreptësisht konfidenciale dhe materialin provues, me përjashtim të materialeve që janë *ex parte* mbrojtësit të viktimave.¹⁹ Mbrojtësi i viktimave duhet të vazhdojë të informojë viktimat pjesëmarrëse për zhvillimet përkatëse në çështje, në një mënyrë që nuk zbulon informacion jopublik.²⁰

9. Gjithashtu, për të garantuar se interesat personale të viktimave pjesëmarrëse përfaqësohen në mënyrën e duhur gjatë gjithë kohës, mbrojtësi i viktimave duhet të vazhdojë të njoftohet dhe të jetë i pranishëm në të gjitha seancat e apelit, qofshin këto seanca publike, private ose të mbyllura, me përjashtim të seancave që janë *ex parte* mbrojtësit të viktimave.²¹ Mbrojtësi i viktimave mund të kërkojë t'i drejtohet Panelit në seancë *ex parte*.²²

10. Gjithashtu, brenda kufijve të përcaktuar në nenin 22(6) të Ligjit dhe rregullën 114(4) të Rregullores mbrojtësi i viktimave mund të vazhdojë të bëjë parashtrime me gojë ose me shkrim, pa kërkuar paraprakisht leje nga Paneli, për cilindo aspekt juridik

¹⁸ Rregulla 114(3) e Rregullores; Vendimi mbi të Drejtat Procedurale të Viktimave gjatë Gjykimit, para. 30, 33. Shih gjithashtu Vendimin mbi Pjesëmarrjen e Viktimave në Procedurën e Apelit në Çështjen *Mustafa*, para. 11.

¹⁹ Shih Vendimin mbi të Drejtat Procedurale të Viktimave gjatë Gjykimit, para. 33. Shih gjithashtu Vendimin mbi Pjesëmarrjen e Viktimave në Procedurën e Apelit në Çështjen *Mustafa*, para. 11.

²⁰ Rregulla 114(3) e Rregullores; Vendimi mbi të Drejtat Procedurale të Viktimave gjatë Gjykimit, para. 33. Shih gjithashtu Vendimin mbi Pjesëmarrjen e Viktimave në Procedurën e Apelit në Çështjen *Mustafa*, para. 11.

²¹ Neni 22(6) i Ligjit; rregulla 114(2) e Rregullores; Vendimi mbi Pjesëmarrjen e Viktimave në Procedurën e Apelit në Çështjen *Mustafa*, para. 12. Shih gjithashtu Vendimin mbi të Drejtat Procedurale të Viktimave gjatë Gjykimit, para. 30, 34.

²² Vendimi mbi të Drejtat Procedurale të Viktimave gjatë Gjykimit, para. 34. Shih gjithashtu Vendimin mbi Pjesëmarrjen e Viktimave në Procedurën e Apelit në Çështjen *Mustafa*, para. 12.

ose në lidhje me faktet dhe të paraqesë përgjigje dhe kundërpërgjigje, sipas rastit, në lidhje me çdo parashtrim drejtuar Panelit, përfshirë edhe dosjet e apelit.²³ Sidoqoftë, Paneli thekson se mbrojtësi i viktimave duhet të shpjegojë qartësisht lidhjen midis parashtrimeve dhe interesave personale të viktimave pjesëmarrëse.²⁴ Rrjedhimisht, mosbindja e Panelit për ekzistencën e kësaj lidhjeje mund të çojë në hedhjen poshtë menjëherë të parashtrimeve.²⁵ Gjithashtu, kur të paraqesë parashtrime me shkrim, mbrojtësi i viktimave duhet të respektojë afatet dhe numrin e lejuar të fjalëve, si dhe kërkesat e tjera formale të përcaktuara në Rregullore dhe në Udhëzuesin e Punës për Dosjet dhe Parashtrimet e Protokolluara.²⁶

11. Së fundi, Paneli i Apelit vëren se ky Vendim nuk përcakton modalitetet e pjesëmarrjes së viktimave për të gjitha situatat që mund të ndodhin në këtë procedurë apeli. Nëse lind nevoja për të specifikuar më tej modalitetet për pjesëmarrjen e viktimave në këtë procedurë, Paneli i Apelit do të japë udhëzime të mëtejshme, ose me kërkesën e palëve ose të pjesëmarrësve në proces, ose me iniciativë të vetën.²⁷

III. VENDIM

12. Për këto arsye, Paneli i Gjykatës së Apelit:

MIRATON modalitetet për pjesëmarrjen e viktimave në procesin e apelit të shtjelluar në këtë Vendim.

²³ Neni 22(6) i Ligjit; rregulla 114(4) e Rregullores; Vendimi mbi Pjesëmarrjen e Viktimave në Procedurën e Apelit në Çështjen *Mustafa*, para. 13. Shih gjithashtu Vendimin mbi të Drejtat Procedurale të Viktimave gjatë Gjykimit, para. 30, 35.

²⁴ Neni 22(3), (6) i Ligjit. Shih gjithashtu Vendimin mbi të Drejtat Procedurale të Viktimave gjatë Gjykimit, para. 35; Vendimi mbi Pjesëmarrjen e Viktimave në Procedurën e Apelit në Çështjen *Mustafa*, para. 13.

²⁵ Vendimi mbi Pjesëmarrjen e Viktimave në Procedurën e Apelit në Çështjen *Mustafa*, para. 13.

²⁶ KSC-BD-15, Udhëzues Pune i Zyrës Administrative, Dosjet dhe Parashtrimet e Protokolluara para Dhomave të Specializuara të Kosovës, 17 maj 2019. Shih gjithashtu Vendimin mbi Pjesëmarrjen e Viktimave në Procedurën e Apelit në Çështjen *Mustafa*, para. 13.

²⁷ Shih Vendimin mbi Pjesëmarrjen e Viktimave në Procedurën e Apelit në Çështjen *Mustafa*, para. 14.

/nënshkrimi/

**Gjykatëse Mishelë Pikar,
Kryegjykatëse**

E mërkurë, 24 korrik 2024

Në Hagë, Holandë.